



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Punlyeto/Prodato Received/Delivory	15.01	2024	viii god yete
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtepi Prirje Apparata	Sasia Koncina Quantity
SHKURTAR	270/2024		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1466/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar; Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë; me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1466/2023 të datës 01.12.2023, të parashtruar nga ankuesja „.....“, me adresë rruga „.....“, Lagja Dardania 1, në Gjilan, kundër Vendimit KA.nr.37/2023 të datës 23.10.2023 të Komisionit për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike „shkelje e të drejtës në pagë“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1 nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1466/2023 e datës 01.12.2023, e parashtruar nga ankuesja**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.37/2023 i datës 23.10.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.**

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës pas përfundim i të procedurës së rekrutimit për pozitën *Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve*, në Gjykatën Themelore në Gjilan, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës akteve të tjera e ndër to edhe Ligjit Nr. 08/L-198 për Pagat në Sektorin Publikë, më datë 30.06.2023 i ka ofruar ankueses Akt Emërimit me Nr. 03/952 për këtë pozitë të cilin ankuesja e ka nënshkruar më datë 03.07.2023, ku sipas këtij akt emërimi përveç pozitës është përcaktuar edhe klasa dhe koeficienti gjegjeshit Klasa J15, Koeficienti 5.85.



Ankuesja më datë 06.10.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimin për ndryshimin e klasës dhe koeficientin gjegjësin në klasë J14, koeficientin 7.5. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 23.10.2023 ka nxjerr Vendim KA.nr.37/2023 më të cilin ka refuzuar si të papranueshme ankesën e ankesës, për shkak të parashtrimit jashtë afatit.

Ankuesja kundër këtij vendimi, përmes postës më datë 27.11.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar më datë 01.12.2023, duke u regjistruar nën shenjë A.nr.1466/2023 me numër protokollit 7152/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me datë 01.04.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7152/2023 të datës 01.12.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 27.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 04.01.2023; Vendimin KA.nr.37/2023 të datës 23.10.2023 të Komisionit për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Fletë dorëzim; Ankesën e datës 06.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Akt Emërimit me Nr. 03/952 të datës 30.06.2023; Vendimin KGJK.nr.01.2023 të datës 18.01.2023; Konkursin e datës 13.06.2022; Listat e pagave për ankuesen nga muaji janar-nëntor 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër, Vendimit KA.nr.37/2023 të datës 23.10.2023 të Komisionit për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se ky komision nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike ngase koeficientit 5.85 ka filluar të realizohet në muajin tetor ndërsa ka konsideruar që ankesa është e pasafatshme. Tutje shton se kategorizimi vendit të punës që ishte bërë në aktin e emërimit dhe në bazë të të cilit është përcaktuar koeficienti i pagës ka qenë degradim dhe kërkon harmonizim nga koeficientit 5.85 në koeficientin 7.5, duke kërkuar që të aprovohet ankesa të shfuqizohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës të bëjë harmonizimin e koeficientit 5.85 në koeficientin 7.5.

Lidhur me objektin e shqyrtimit të kësaj lënde, Kolegji nga provat e lëndës ka gjetur se me datë 23.01.2023, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovë, lidhur me zbatimin e shtojcës Nr.2-Sistemi Gjyqësor, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ka nxjerrë Vendimin me numër KGJK.nr.01/2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, vendim ky i zbatueshëm nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Rrjedhimisht, sipas këtij vendimi pozita e ankueses *Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve*, është klasifikuar në grupin e pozitave profesionale Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85, kështu që bazuar edhe në këtë vendim, organi i punësimit pas përfundimit të konkursit 02/2020 të datës 13.06.2022 dhe përzgjedhjes së ankueses për pozitën e shpallur *Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve*, në Gjykatën Themelore në Gjilan, ka lëshuar për ankuesen Akt Emërimit me Nr. 03/952 të datës 30.06.2023, Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85, i nënshkruar nga ankuesja me datë 03.07.2023.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: 1. *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.* Ndërlidhur me këtë me nenin 127 paragrafin 1 të të njëjti ligj parashihet se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ..."*. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe bazuar në provat materiale të kësaj çështje administrative, Kolegji konstatoi se ankuesja me datë 03.07.2023 ka nënshkruar pa vërejtje Akt Emërimit me Nr.03/952, e sipas këtij akt emërimi kanë qenë të përcaktuar, grupi, klasa dhe koeficienti, respektivisht Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85, ndërsa ankuesja me datë 06.10.2023, parashtron ankesë në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kështu që mbi këto fakte rrjedhë se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 06.10.2023 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pra nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit 03.07.2023 e deri në datën e parashtrimit të ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë kaluar mbi 30 ditë, dhe si pasojë pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, ndërsa Vendimi KA.nr.37/2023 i datës 23.10.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas Kolegjit të Këshillit në këtë kontekst është juridikisht i ligjshëm dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në arsyetimin si më sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1466/2023, datë 15.01.2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor i Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

